

VENDIM
Nr.320, datë 5.5.2010

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË OBJEKTIT “GODINA E KONVIKTIT” NGA SHOQËRIA “TRAJTIMI I STUDENTËVE NR. 2” SHA, TIRANË, TE UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2002 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, dhe të nenit 82 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të objektit “Godina e konviktit” bashkë me truallin nën godinë, që ndodhet brenda territorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, nga shoqëria “Trajtimi i studentëve nr.2”, sh.a., Tiranë, tek Universiteti i Sporteve të Tiranës, sipas planimetrive dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI I RILEVIMIT

PERGATITI

Ing. Sokol Allaraj

Liq. Nr. TZ 0332 Dt. 02/05/01

Ing. SOKOL ALLARAJ
Punime Topo Gjeodezike
Projektim - Zbatim

Data e Pergatites Tirane me 12 /04 / 2010

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3266 NR. PASURISE 3/56

INDEKSI I HARTES TR-N-7 SHKALLA 1:500

ADRESA E PASURISE RRETHI TIRANE Q. TIRANE
Rruga "M. Gjollështa"

IDENTIFIKIMI I PASURISE

V - 3/56

L - 3/56

J - 3/56

P - 3/56

PRONARI


KONVIKTI I STUDENTEVE TE
UNIVERSITETI I SPORTEVE TIRANE
(ISH INSTITUTI I FISKULTURE)

Siperfaqja e katit perdhe S1 = 899.0 m²
Siperfaqja e katit pare S2 = 567.0 m²
Siperfaqja e katit dyte S3 = 567.0 m²
Siperfaqja e katit trete S4 = 567.0 m²
Siperfaqja e totuarit S5 = 221.0 m²
Siperfaqja e truallit poshte Objektit St = 899.0 m²


Siperfaqja e Totale e ndertimit S1+S2+S3+S4 = 2600.0 m²

Siperfaqja Totale e truallit St = 1120.0 m²

 Trotuari
Ndertesa 1 Kat
Ndertesa 4 Kate




Sip. = 899.0 m²



PLANIMETRIA E KATIT 1, 2, 3 SHKALLA 1:100

S₀ = 567.0 m²



PROJEKTI
E. SHKOLLIM
M. 72.03.03
P. 100.01.11.18.17
P. 100.01.11.18.17
P. 100.01.11.18.17
P. 100.01.11.18.17